



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2019:088686

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525491

Rev.nr.523/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Zenel Leku, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. (F.) P., nga Gj., të cilin me autorizim e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gj., kundër të paditurve: 1. Telekom i Kosovës Sh.a, në P., të cilën e përfaqëson i autorizuari S. Th., jurist nga P. dhe 2. K. e S. “E.” Sh.a nga P., rr.”....”, nr..., të cilën me autorizim e përfaqëson F. M., nga P., me objekt të padisë kompensim dëmi, vlera e kontestit 28.500,00 euro, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2976/2021, të datës 29.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 26.11.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Pranohet pjesërisht si i bazuar revizioni i paditësit, ndryshohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2976/2021, të datës 29.07.2024, dhe ai i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.405/2016, i datës 24.11.2020, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike, ashtu që detyrohet e paditura, Telekom i Kosovës Sh.a, në P., për 80% të përgjegjësisë, t' ia kompensoi dëmet jo materiale në emër të dhimbjeve fizikë, shumën prej 2,800.00 €, ndërsa në pjesën tjetër, revizioni i paditësit, refuzohet si i pabazuar.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.405/2016, të datës 24.11.2020, ishte vendosur " I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit B. P., nga Gj., dhe detyrohet e paditura 1. Telekom i Kosovës Sh.a në P. që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të i

paguaj paditësit B. P., nga Gj., dhe atë: - Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumë prej 6.000,00 euro, - Në emër të dhimbjeve fizike trupore shumë prej 900,00 euro, - Në emër të frikës shumë prej 700,00 euro. - Në emër të shëmtimit, shumë prej 1.000,00 euro, - Në emër të ndihmës së huaj shumë prej 50,00 euro. - Në emër të ushqimit të përforcuar, shumë prej 50,00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 8.700,00 euro, me kamatë vjetore 8%, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesë definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e nxjerrës së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive. II. Detyrohen e paditura 1. Telekom i Kosovës Sh.a në P. që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 1.000,00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit B. P. nga Gj., mbi shumë e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, si dhe për shërim klimaterik dhe terapeutik si dhe shpenzimet mjekësore, e deri në shumë e përgjithshme të kërkuar prej 28.500.00 euro, refuzohet si e pa bazuar. IV. Kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurës 2. K. e S. "E." Sh.a nga P., refuzohet në tërësi si e pa bazuar."

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2976/2021, datë 29.07.2024, ishte vendosur " I. Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit B. P. nga Gj., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.405/16 të datës 24.11.2020, në pikën I të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jo material dhe material dhe gjykohet: Detyrohet e paditura Telekom i Kosovës Sh.a, në P., që paditësit B. P., për shkak të lëndimit në punë më dt. 24.05.2016, për 80% të përgjegjësisë, t'ia paguajë shumat si në vijim: Për dëmin jo material: -për dhimbje trupore-fizike, shumë prej 1.000 € -për frikën e përjetuar shumë prej 2.800€ -për shëmtimin trupor shumë prej 1.500€ . Për dëmin material: -për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 56€, -për ushqim të përforcuar shumë prej 56€ -shumat e gjykuara t'ia paguajë me kamatë prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këto forma të dëmit përtej shumave të gjykuara, refuzohet e pathemeltë. II. Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e B. P. nga Gj., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.405/16 të datës 24.11.2020, në pikën II të dispozitivit dhe gjykohet: Detyrohet e paditura Telekom i Kosovës Sh.a, në P., që paditësit B. P. t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në lartësi prej 1872.64 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar për shpenzimet e procedurës refuzohet e pathemeltë III. Refuzohet pjesërisht e pathemeltë ankesa e paditësit dhe në tërësi ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.405/16 të datës 24.11.2020, në pikën I të dispozitivit për dëmin jo material në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për kamatën e gjykuar, në pikën III të dispozitivit për pjesën e

refuzuar të kërkesëpadisë për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për shërim klimaterik dhe terapeutik, për shpenzime mjekësore dhe në pikën IV të dispozitivit, vërtetohet".

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi B. P., përmes të autorizuarit avokat Teki Bokshi, ka paraqitur revizion për pjesën refuzuese, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimote dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me kërkesë që revizioni të aprovet dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë dhe kërkesëpadija të aprovet në tërësi si dhe të pranohen shpenzimet e procedurës.

E paditura, Telekom i Kosovës, nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit, është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 11.08.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi ndaj të paditurave Posta dhe Telekomikacioni i Kosovës Sh.a (PTK) në P. dhe K. e S. "E." Sh.a nga P., për kompensimin e dëmit material dhe jo material, sipas bazës juridike të lëndimit në punë, ndërsa me parashtrësën e dt.08.10.2020, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës së shkallës së parë që të detyrojë të paditurat që paditësit solidarisht t'i paguajnë për dëmin material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 28.500,00 euro, me kamatë vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'ia kompensojnë shpenzimet procedurale në shumë prej 2,855.60 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare. Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe precizimit të kërkesëpadisë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.405/16 të datës 24.11.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore paditësi është punëtor i të paditurës së parë Telekom i Kosovës, i punësuar në detyrat e punës montator, i cili më datën 24.05.2016, rreth orës 13.55/h, gjatë kryerjes së detyrave të punës ka pësuar aksident në punë, ku edhe ka pësuar lëndimi gjatë kryerjes së detyrave të punës. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar përmes ekspertizës nga eksperti për siguri dhe mbrojtje në punë Dr.sc. A. K. të dt.07.11.2018, si dhe dëgjimi i tij në seancën kryesore të datës 15.05.2019, ka vërtetuar faktin se shkaqet e lëndimit të paditësit kanë të bëjnë me lëshimet

e punëdhënësit Telekom i Kosovës dhe vet punëtorit (paditësit). a) Lëshimet (neglizhenca) e Telekomit bazohet në atë se: Punëdhënësi ka angazhuar punëtorin për punë në lartësi pa i plotësuar si duhet kushtet nga aspekti i sigurisë në punë për veprim të sigurte. Shkallët e aluminit të përbëra prej tre pjesëve nuk janë të sigurta për kryerjen e veprimeve në shtylla, sepse kontakti i tyre me shtyllën është pikë dhe kjo nuk garanton kurrfarë stabiliteti të tyre, e posaçërisht në shtyllë të lagur dhe kushte të vështira atmosferike. Në këtë rast punëdhënësi është dashur të sigurojë automjetin me shportë në të cilin punëtori do të ishte i sigurt gjatë veprimeve punuese në lartësi. b) Lëshimet e punëtorit bazohen në: Ka kryer veprimin punues në lartësi me shkallë, të cilat nuk kanë qenë plotësisht në rregull, ku vetë ka deklaruar se nuk kanë pasur siguresën nga njëra anë. Punëtori ka qenë i obliguar që ta paraqes këtë problem tek udhëheqësi i tij dhe ta refuzoj hipjen në shtyllë përmes atyre shkallëve. Prandaj eksperti është i mendimit se punëdhënësi dhe punëmarrësi janë bashkëpjesëmarrës në krijimin e kushteve për lëndimin e punëtorit në punë, në përpjesëtim me numrin e lëshimeve të tyre të bëra, të cilat janë specifikuar nën a) dhe b).

Paditësi në aksident ka pësuar këto lëndime: 1. Tronditje të kokës, pjesës së fytyrës regjionin e hundës. 2. Plagë shqyese në trupin e hundës dhe thyerje të kockës së hundës, e që kualifikohen lëndime të rënda trupore, të cilat janë manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 20 min, të rëndë 24 orë, të mesëm 7 ditë, të ulët 6 javë, ka zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësor 15 %, shëmtim të shkallës së lehtë (vragë në fytyrë me pengesë funksionale - indet e buta dhe deformimet e kockave), ka pasur nevojë për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë 7 ditë, ushqim të përforcuar për 7 ditë, ka pasur nevojë për terapi fizikale 10 ditë.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës KS "E.", sh.a. me seli në P., me të cilën e paditura e parë ka pas kontratë për sigurimin shëndetësor të punëtorëve, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit pasi që e paditura KS "E.", sh.a. me seli në P., ka pasur për detyrim vetëm pagimin e shpenzimeve mjekësore të cilat i ka paguar sipas kërkesës së paditësit dhe nuk ka pasur për detyrim edhe kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë, aktgjykimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e neneve 136 lidhur me nenin 32 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe dispozitave të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nr. 04/L-161, si dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 173 të LMD-së, si dhe dëmit jo material konform nenit 183 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD, ndërsa për shpenzimet procedurale gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, përveç në pjesën ku aktgjykimi i ankimuar është dashur të ndryshohet.

Gjykata e Apelit nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, erdhi në përfundim që kemi ndarje të përgjegjësisë, edhe pse gjykata e shkallës së parë nuk ka cekur në mënyrë precize shkallën e ndarjes së përgjegjësisë, ajo e arsyeton se kishte ndarje të përgjegjësisë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në mendimin e ekspertit për siguri dhe mbrojtje në punë, duke mos e cekur në përqindje kontributin, por që sipas sqarimeve të ekspertit të sigurisë dhe mbrojtjes në punë në seancë gjyqësore, gjykata ankimore si pasojë e këtij lëndimi në vendin e punës, bëri ndarjen e përgjegjësisë 80% për të paditurën dhe 20% për paditësin.

Gjykata e Apelit i pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të paditësit sa i përket shumave të gjykuara, e duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në kuptim të nenit 195 par.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit që i referohet dëmit jomaterial për dhimbje trupore-fizike, për frikën e pësuar dhe shëmtimin trupor, si dhe për dëmin material për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar, ku kjo gjykatë gjeti se shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së parë nuk janë proporcionale të mirën e shkelur, andaj i ka ritur shumat për këto forma të dëmit, ashtu që për paditësin, për dhimbje trupore-fizike ia ka gjykuar shumën prej 1,000.00 € dhe për frikën pësuar në shumën prej 2,800.00 € ndërsa për shëmtimin trupor shumën prej 1,500.00 €, duke vlerësua se shumat e gjykuara janë në proporcion me llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore, kohëzgjatje dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës të pësuar, si rezultat i lëndimeve trupore, i cili sipas ekspertizës mjekësore është lëndim i shkallës së rëndë, ndërsa shëmtimi është kryesisht në fytyrë. Shumat e gjykuara nga gjykata më e lartë janë kompatible me të mirën e shkelur dhe që iu shkon përshtati synimeve për të cilat ka për qëllim kompensimi, e që është një satisfacion për palën e dëmtuar që sado pak ti zbusë pasojat e dëmtimeve, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar e refuzoi si të pathemeltë, për shkak se nuk janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Po ashtu edhe për dëmin material për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar kjo gjykatë i ka ritur shumat, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore të cilat kanë përcaktuar kohëzgjatjen e nevojës për këto dy forma të dëmit, ashtu që për ndihmën e huaj ia ka gjykuar shumën 56.00 € dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 56.00 €, ngase sipas ekspertizës mjekësore paditësi ka pasur

nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 7 ditësh, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 7 ditësh, i pajisur me proteina, minerale, vitamina etj, andaj kjo gjykatë ka vlerësuar se shumat e gjykuara për dëmin material janë shuma proporcionale me kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar, për 80% të përgjegjësisë së të paditurës së parë, ndërsa shumat e kërkuar nga paditësi përtej shumave të gjykuara është refuzuar e pathemeltë.

Gjykata e Apelit, në përputhje me ndryshimin e aktgjykimit e ndryshoi edhe vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore, e duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse ka vlerësuar se vendimi për shpenzimet e procedurës nuk është marrë në përputhje në dispozitat ligjore të nenit 452.2 të LPK-së.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit, tani në bazë të përgjegjësisë së ndarë 80% me 20% , dhe refuzimin e pjesës së kërkesëpadisë përtej shumave të aprovuara dhe se në këtë pjesë ku kemi të bëjmë me aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit, aktgjykimet nuk përfshihen me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK, Gjykata e Revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës e mbështet arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë që ka pasur parasysh se kompensimi i dëmit jo material paraqet satisfaksion për t'i zbutur çrregullimet në sferën shpirtërore të dëmtuarit, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me llojin e dëmit jo material si pasojë e dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të kompensimit për dhimbje shpirtërore si pasojë e shëmtimit trupor, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në harmoni me praktikën gjyqësore të deritashme të gjykimit të dëmshpërblimit në raste të ngjashme. Prandaj, pretendimet në revizion, të paraqitura nga pala paditëse lidhur me lartësinë e shumave të gjykuar nga gjykata e shkallës së dytë, në këto kategori të dëmeve Gjykata Supreme i vlerëson si të pa themelta.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në pretendimet e paditësit në revizion, të cilat lidheshin kryesisht me shumat e gjykuara, gjeti se në emër të kompensimit të dëmit jo material për sa i përket kompensimit të dëmit në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e dhimbjeve fizike, shumat e gjykuara nuk është në përputhje adekuate me dëmin e shkaktuar dhe për këto arsye vendosi që të ndryshoi shumën si në dispozitiv. Duke iu referuar Udhëzuesit për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material dhe kriterëve të

cilat shërbejnë për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit (satisfaksioni) të dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e dhimbjeve fizike, paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,800.00, dhe kjo gjykatë konsideron se kjo shumë është adekuate dhe e përafërt me të mirën e dëmtuar dhe në përputhje me praktikën gjyqësore, dhe paraqet kompensim të drejtë, me të cilin mund të realizohet qëllimi.

Në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës, ka caktuar shumë e kompensimit duke pas parasysh se personit të lënduar që ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë i përket e drejta e kompensimit, lartësia e të cilit varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre dhe kjo në çdo rast konkret vërtetohet me anë të ekspertimit. Kjo ishte vërtetuar dhe sipas Gjykatës Supreme shuma prej 2,800.00 € për këtë kategori është adekuate dhe mbi këtë bazë u caktuan shumat për të cilat Gjykata Supreme konsideron se duke marr para sysh pretendimet në ankesë dhe ato në revizion ndryshimi i shumës së caktuar në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e frikës dhe dhimbjeve fizike, nuk kishte një arsyetim adekuat nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, edhe për dhimbje shpirtërore si pasojë e frikës dhe dhimbjeve fizike, si formë e veçantë e dëmit jo material, i takon e drejta e kompensimit të drejtë në të holla, i cili sipas konstatimit të kësaj Gjykate, duhet të caktohet në shumën prej 2.800.00 € me të cilën arrihet qëllimi i këtij kompensimi. Kjo për faktin se në ekspertizë mjekësore thuhet se paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe ka pasur frikë me intensitet dhe kohëzgjatje përafërsisht të njëjta dhe gjykata e shkallës së dytë dështoi të arsyetoi këtë ndryshim.

Prandaj Gjykata Supreme ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 224 paragrafi 1, i LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me kompensimin e dëmit jo material për sa i përket dhimbjeve shpirtërore si pasojë e dhimbjeve fizike.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit rreth konstatimeve të ekspertizave që paraqesin saktësisht intensitetin e lëndimeve dhe të, pasojave nga këto lëndime, ndërsa pretendimet e tanishme kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilën në bazë të nenit 214 të LPK-ës, revizioni nuk mund të paraqitet, si dhe të njëjtat kanë qenë pretendime të paraqitura edhe para gjykatave të instancës më të ulët, për të cilat pretendime ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme në aktgjykimet e tyre, andaj kjo gjykatë nuk e pa të nevojshme që ato të përsëriten edhe një herë, por arsyetimin e dhënë në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët e mbështetë si të drejtë e të bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë në bazë të nenit 224.1 dhe të nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.523/2024, datë 26.11. 2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islam